



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25.02.2025

Nr: 196

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN
NR. 40 ID, DATË 19.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË
KOMITETIT SHQIPTAR TË HELSINKIT/KSHH**

Sot më datë 25.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Komiteti Shqiptar i Helsinkit

SUBJEKT: **Z. Pjerin Ndreu**
Kryetar i Bashkisë Lezhë

OBJEKT: Për një veprimtari publike të ndaluara në Bashkinë Lezhë

BAZA LIGJORE: Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator

KONSTATOJ:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit/ KSHH, më datë 19.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 40 ID.

Në këtë denoncim Komiteti Shqiptar i Helsinkit parashtron sa vijon:

“Në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë, më datë 10.05.2025, është shpallur njoftimi nëpërmjet të cilit janë hapur aplikimet për programin social të strehimit “Subvencionimin e interesave të kredisë”. Në një njoftim të dytë të datës 11.02.2025, nëpërmjet faqes së internetit të Bashkisë Lezhë, njoftohet zgjatja e afatit të aplikimeve, deri në datën 11.03.2025, duke e shtyrë afatin me një muaj.

Data: 25.02.2025

Nr: 196
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 40 ID, datë 19.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të KSHH”

Sipas nenit 91, pika 4, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar dhe nenit 3, pika 3, të vendimit nr. 9, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar një masë e tillë e marrë nga ana e Bashkisë Lezhë 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve, përbën një veprim të ndaluar të shprehur në formën e “dhënies së përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë.”

Nga sa më sipër çmohet se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
 - Z. Pjerin Nderu, Kryetar i Bashkisë Lezhë.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI